

Sillabusi për lëndën Shqipja e shkruar

Universiteti Hasan Prishtina

Fakulteti i Filologjisë

Dega e Letërsisë Shqipe

Titulli i kursit:**Shqipja e shkruar**

Niveli dhe lloji i kursit:**Lëndë obligative**

Viti I,sëmestri I

Vlera në kredi (ETC): 6

Fondi i orëve; **2+1**

Mësimdhënëse ;Prof.dr ass.Hava Qyqalla tel.044 125 886; imeli;havaqyqalla@hotmail.com

### **Qëllimi i kursit**

-Përvetësimi dhe thellimi i mëtejshëm i njohurive gjuhësore,të fituara më parë,sidomos arritja e një përdorimi sa më të drejtë të gjuhës standarde në të gjitha normat e saj,fonetike ,morfologjike, leksikore e sidomos në atë drejtshkrimore dhe drejtshqiptimore.

-Nxitja dhe motivimi për ligjërim të rrjedhshëm,pavarësisht nga llojet dhe format e tipit të kumtimit në të gjitha përdorimet e gjuhës qoftë me gojë ,qoftë me shkrim.

-Aftësimi për shkrimin sa më të drejtë e më normativ të shkrimeve të lira si ese ,punime seminarike,punim diplome e gjer tekpunimet shkencore.

-Përgjithësisht kërkohet arritja edhe formimi i aftësive shprehëse gjuhësore për zbatim të drejtë të normës drejtshkrimore e drejtshqiptimore të shqipes standarde.

### **Rezultatet e pritura të nxënies:**

Përvetësimi i njohurive dhe i shkathtësive bazë për zotërimin e drejtshkrimit e të drejtshqiptimit

Formimi i shprehive për punë të pavarur interpretuese,krijuese dhe shprehëse ,përkitazi me standardin etj.

Përvetësimi i teknikave ,procedurave e strategjive metodologjike drejtshkrimore e drejtshqiptimore në teori e në praktikë.

### **Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje:**

-që të zotërojë në teori e në praktikë njohuritë e gjuhës standarde shqipe;

-që të pavarësohet në zbatimin e këtyre njohurive të shqipes standarde si në mësimdhënie ashtu edhe në shoqëri;

-që të aftësohet për punë të pavarur interpretuese dhe shkrimore;

-që të formojë shprehje të shkathtësi për motivim të vetvetëshëm në zbatimin e gjuhës standarde kudo që e përdor gjatë punës.

Metodologjia e mësimdhënies: e kombinuar, varësisht nga lloji i ligjëratë (shpjegim teorik, analiza tekstore, ushtrime, diskutime debatuuese, punë me grupe, hartime krijuese, hulumtim të pavarur etj.

### **Literatura bazë:**

1. Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Prishtinë, 1974
2. Rami Memushaj, Shqipja standarde, si ta flasim dhe ta shkruajmë, Tiranë, 2004
3. Gjovalin Shkurtaj, Kultura e gjuhës, Tiranë, 2006
4. Grup autorësh, Gjuha letrare shqipe, Prishtinë, 1984
5. Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe, cilido publikim
6. Fjalori i gjuhës shqipe, cilido publikim
7. Vepra letrare, nga tradita dhe letërsia e sotme, për sa më shumë ushtrime.

### **Plani detaj i mësimi, java, temat dhe literatura:**

#### **Java I**

Nocioni gjuhë letrare a standarde, veçoritë e shqipes standarde

#### **Java II**

Gjuha standarde dhe dialektet

#### **Java III**

Probleme të përvetësimit të normës letrare, faktorët: jashtëgjuhësorë, gjuhësorë, kalket sintaksore

#### **Java IV**

Parimet e drejtshkrimit të shqipes dhe zbatimi i tyre në shkrimin e shqipes

#### **Java V**

Apostrofi, përdorimi dhe mospërdorimi i tij

## **Java VI**

Shumësi i emrave, mënyrat e formimit të shumës dhe çështje të lidhura me drejtshkrim

## **Java VII**

Pjesorja e shqipes ,tipat e saj dhe çështje të lidhura me drejtshkrimin e saj

## **Java VIII**

Përdorimi i ë-së patheksuar fundore tek emrat;

Vlerësim njohurish të materialit të shtjelluar **Testi I** vlerësues

## **Java IX**

Përdorimi i ë-së së patheksuar te foljet

## **Java X**

Përdorimi dhe mospërdorimi i ë-së së patheksuar te pjesët e tjera të ligjëratës

## **Java XI**

Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj

## **Java XII**

Përdorimi dhe drejtshkrimi i nyjës së përparme

## **Java XIII**

Shkrimi i fjalëve njësh ndaras dhe me vizë në mes

## **Testi II vlerësues**

## **Java IV**

Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi i disa formave gramatikore më të përdorshme, sidomos i disa përemrave ,fomash foljore etj.

## **Java XV**

Përdorimi i shenjave të pikësimit dhe i shkronjës së madhe.

## **Metodat e vlerësimit:**

Vlerësimi i parë.....20%

Vlerësimi i dytë.....25%

Angazhime të tjera në fakultet dhe në shtëpi.....10%

Vijimi i rregullt.....	5%
Provimi përfundimtar.....	40%
Totali .....	100%